



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 763/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.12.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me objekt: “*Rikonstruksioni i varrezave publike Peshkopi, Viti 2017*”, me nr. REF-31521-10-26-2017, me fond limit 3,725,685 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.11.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

Ankimues: Operatori ekonomik “SHEHU” sh.p.k..
Adresa: Maqellarë, Dibër.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Dibër.
Adresa: Bulevardi “Eles Isufi”, Dibër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Rrethanat e çështjes



II.1. Në datën 27.10.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: “Rikonstruksioni i varrezave publike Peshkopi, Viti 2017”, me nr. REF-31521-10-26-2017, me fond limit 3,725,685 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.11.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

II.2. Në datën 30.10.2017, operatori ekonomik ankimues “SHEHU” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme e konkretisht:

“[...]Kerkojme heqjen e Certifikatave 1. BS ISO 39001:201 Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne rruge dhe 2. EN-ISO 3834-2:2006 Per sistemin e menaxhimit te cilesise se saldimit sepse asnjera nga keto certifikata nuk kan lidhje me preventivin e zerat e tij te punimeve por vertem kufizon e diskriminon pjesemarjen e OE ne procedurat e prokurimit Publik.(Prandaj kerkojme te modifikohet kjo pike).Objekti i punimeve nuk ka lidhje me Sigurine Rrugore dhe manaxhimit te cilesise se Saldimit.

Kerkojme heqje te ketyre Paisjeve:

1. Autobetonjere stacionare 1-2 m³ sepse eshte vendosur nje Betoniere 0.5m³

2. Aparat per ngjitje tubash

3. Rul vibrues mbi 10 ton te hiqet dhe te mbetet Rul Vibrues.

4. Tabela paralajmeruese cop 6 te ulet numri ne 2 cop

5. Komplet i ndihmes se shpejte cop 6 te ulet numri ne 2 cop

6. Saldatrice me argon 400A te hiqe me argon 400A dhe te lihet Saldatrice

7. Kokore pune ne pronesi ose me qera 14 cope duhet te ulet numri ne 5 cop

8. Fikse zjarri cop 3 te hiqet fare sepse kriteri i mësipërm nuk është proporcional me objektin e prokurimit. Roli i subjekteve juridikë privatë, parashikuar edhe nga "Ligji për mbrojtjen nga zjarri", është i kufizuar në marrjen e masave parandaluese dhe njoftimin e organeve të specializuara në rast të rënies së zjarrit. Kërkesa e autoritetit kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet kenë te pakten 3 është një kriter i ekzagjeruar dhe që nuk përputhet me natyrën e kontratës objekt prokurimi prandaj duhet te modifikohet.

Te gjitha kerkesat e pikes se dyte duhet te modifikohen sipas konstatimit sepse jane diskriminuese per OE.

Vertetimi per Numri mesatar i punonjësve për periudhën Janar 2015 -Shtator 2017 të jetë jo më pak se 14 punonjës eshte shume i ekzagjeruar per hapsiren kohore shume te madhe te shtrirjes me shume se 3 vjet dhe diskriminon OE prandaj edhe kjo pike duhet te Modifikohet deri ne 10 Punonjes ose te shikohet ecuria e nje viti me pare me qellim qe te siguroje barazi dhe konkurrence te drejte e te ndershme e jo diskriminuese te OE pjesemares ne procedurat e prokurimit Publik.

d)Operatori ekonomik duhet te kete te siguruar ne listepagesa per periudhen Janar 2016 - Shtator 2017. Duhet te modifikohet Janar- shtator: 2017.

2. Shofer (nje) (per shoferin te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional te leshuar nga insitucionet perkatese) Duhet te modifikohet per shoferin te paraqitet deshmia e kualifikimit Leje Drejtimi (Patente).

3. Murator (dy) (per muratorete te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional dhe deshmia e kualifikimit te sigurimit teknik , te leshuar nga institucionet perkatese) Duhet te modifikohet te hiqet fare

4. Teknik Ndertimi (nje) (per teknikun e ndertimit te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional) Duhet te modifikohet te hiqet Fare sepse e mbulon drejtuesi teknik te eshte ing. E eshte drejtuesi me i larte i shoqerise

e) Operatori ekonomik duhet te kete kontrate pune me keto specialiste :

1. Saldator (nje) te paraqitet (deshmi kualifikimi profesional , kontrata e punes dhe deshmia e sigurimit teknik) Duhet te modifikohet te hiqet fare

2. Manovrator (dy) te paraqitet (deshmi kualifikimi profesional , kontrata e punes dhe deshmia e sigurimit teknik) Duhet te modifikohet te hiqet fare

3. Hekurlidhes (nje) te paraqitet (deshmia e kualifikimit profesional dhe kontarta e punes) Duhet te modifikohet te hiqet fare.

Pikat e larte permendur duhet te modifikohen sipas kerkeses sone [...]”

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ përkatës, konstatohet autoriteti kontraktor nuk ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues.

II.4. Në datën 08.11.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Në datën 24.11.2017, nëpërmjet shkresës me nr.5331/1 prot., datë 22.11.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “SHEHU” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Kerkojme heqjen e Certifikatave 1. BS ISO 39001:201 Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne rruge dhe 2. EN-ISO 3834-2:2006 Per sistemin e menaxhimit te cilesise se saldimit sepse asnjera nga keto certifikata nuk kan lidhje me preventivin e zerat e tij te punimeve por vertem kufizon e diskriminon pjesemarjen e OE ne procedurat e prokurimit Publik.(Prandaj kerkojme te modifikohet kjo pike).Objekti i punimeve nuk ka lidhje me Sigurine Rrugore dhe manaxhimit te cilesise se Saldimit.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit pika 2.3.2 të shtojcës 10, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

“2.3.2 Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë certifikatat:

- *UNI EN ISO 14001:2004 Për sistemin e menaxhimit të mjedisit*
- *PAS: 99:2012 Per sistemin e integruar te menaxhimit*
- *BS ISO 39001:201 Per sistemin e menaxhimit te sigurise ne rruge*
- *EN-ISO 3834-2:2006 Per sistemin e menaxhimit te cilesise se saldimit*
- *EN ISO 9001-2008 Per Menaxhimin e Cilesise*
- *BS OHSAS 18001:2007 (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe te sigurinë se punonjesve në punë)*

Ne rast te bashkimit te operatoreve secili prej anetareve te bashkimit duhet te kete certifikaten ISO te kerkuar me siper”.

III.1.2. Në nenin 46, pika 2 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: 2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]*”

III.1.3. Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “1. *Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*”

III.1.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi disponueshmërinë e certifikatës BS ISO 39001 “Për menaxhimin e sigurisë rrugore”, KPP vëren se certifikimi sipas ISO 39001 demonstron pjesëmarrjen e organizatës për të ulur numrin e vdekjeve dhe të plagosurve në aksidentet rrugore, të respektojë kërkesat ligjore referuar ndaj sigurisë të trafikut rrugor dhe të përmisojë në mënyrë të vazhdueshme performancën në fushën e sigurisë rrugore. KPP gjykon se legjislacioni në fuqi për prokurimin publik i jep mundësinë autoriteteve kontraktore që të kërkojnë certifikime nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar, në mënyrë që të vërtetojnë se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, por me kushtin që certifikimet e kërkuara të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit si dhe preventivit të punimeve të pasqyruar në shtojcën 1 të dokumentave të tenderit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nuk jemi në kushtet e ndërtimit të rrugëve urbane, interurbane apo rrugë me trafik të dëndur rrugor, që të nevojiten masa të posacme për parandalimin e aksidenteve dhe rritjen e sigurisë rrugore. Në këto kushte, KPP gjykon se kërkimi nga ana e autoritetit kontraktor për disponimin e certifikatës BS ISO 39001 “Për menaxhimin e sigurisë rrugore”, nuk është në përpjesëtim me volumin dhe objektin e kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet ta heqi këtë kërkesë.

Ndërsa lidhur pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi disponueshmërinë e certifikatës EN-ISO 3834-2:2006 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit”, KPP vëren se certifikimi i sipërcituar shërben për prodhimin me saldimit, e cila është përgatitur me qëllim të përcaktojë kërkesat e cilësisë për prodhuesit që merren me prodhimin e produkteve me metodën

e shkrijes me saldim. Standarti EN ISO 3834-2 për certifikim ka të bëjë vetëm me burimin dhe cilësinë e produktit që mund të rrjedh nga burimi dhe operimet e ndërlidhura. Standartet janë përdorur si bazë për vlerësimin e e cilësisë së saldimit të prodhuesve. Sa më sipër, referuar objektit të prokurimit objekt shqyrtimi, KPP konstaton se nuk jemi në kushtet e blerjes së produkteve të prodhuara me metodën e shkrijes me saldim, në mënyrë që të kërkohet që prodhuesi i tyre të disponojë certifikimin për standartin EN ISO 3834-2. Në këto kushte, KPP gjykon se kërkimi nga ana e autoritetit kontraktor për disponimin e certifikatës të sipërcituar, nuk është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet ta heqi këtë kërkesë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me kriterin e mësipërm qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se “Kerkojme heqje te ketyre Paisjeve:

1. *Autobetonjere stacionare 1-2 m3 sepse eshte vendosur nje Betoniere 0.5m3*

2. *Aparat per ngjitje tubash*

3. *Rul vibrues mbi 10 ton te hiqet dhe te mbetet Rul Vibrues.*

4. *Tabela paralajmeruese cop 6 te ulet numri ne 2 cop*

5. *Komplet i ndihmes se shpejte cop 6 te ulet numri ne 2 cop*

6. *Saldatrice me argon 400A te hiqe me argon 400A dhe te lihet Saldatrice*

7. *Kokore pune ne pronesi ose me qera 14 cope duhet te ulet numri ne 5 cop*

8. *Fikse zjarri cop 3 te hiqet fare sepse kriteri i mësipërm nuk është proporcional me objektin e prokurimit. Roli i subjekteve juridikë privatë, parashikuar edhe nga “Ligji për mbrojtjen nga zjarri”, është i kufizuar në marrjen e masave parandaluese dhe njoftimin e organeve të specializuara në rast të rënies së zjarrit. Kërkesa e autoritetit kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet kenë te pakten 3 është një kriter i ekzagjeruar dhe që nuk përputhet me natyrën e kontratës objekt prokurimi prandaj duhet te modifikohet.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në dokumentat e tenderit, shtojca 10 pika 2.3.3, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

”Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
1.	<i>Kamiona me ngarkese mbajtese mbi 8 ton</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>2 cope</i>
2.	<i>Betoniere 0.5 m3</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
3.	<i>Minieskavator</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>

4.	<i>Kamioncine</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
5.	<i>Karroca dore</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>5 cope</i>
6.	<i>Vibrator thellesie</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>2 cope</i>
7.	<i>Fadrome</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
8.	<i>Saldatrice me argon 400A</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
9.	<i>Depozite uji 5000l</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
10.	<i>Motogjenerator</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
11.	<i>Matrapik</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>2 cope</i>
12.	<i>Kokore pune</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>14 cope</i>
13.	<i>Fikse zjarri</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>3 cope</i>
14.	<i>Komplet I ndihmes se shpejte</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>6 cope</i>
15.	<i>Tabela paralajmeruese</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>6 cope</i>
16.	<i>Rul vibrues mbi 10 ton</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
17.	<i>Aparat per ngjitje tubash</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
18.	<i>Autobetonjere stacionare 1 – 2 m³</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>2 cope</i>

Makineritë – pajisjet në pronësi të vërtetohen me anë të aktit të pronësisë duhet te paraqitet fature tatimore shitjeje dhe kontrata e shitblerjes ose akt zhdoganimi . Ato të marra me qera të shoqërohen me kontratë noteriale qiraje (ose formë tjetër huaje) si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qira të mjeteve. Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet edhe: leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik , taksat dhe policën e sigurimit të mjeteve.”

III.2.2. Në nenin 26, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin

kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.2.4.Në shtojcën 1 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka pasqyruar preventivin me zerat dhe volumet e punimeve si më poshtë:

NR .	NR.ANA L.	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESI A	SASI A	CIMIM I	VLEFT A
		1. PUNIME Karburanti i porta e hyrjes				
1	2,426	Prishje mure me blloqe (avlli ekzistuese)	m3	3		
2	An.48	Prishje mure guri them.+xokol	m3	7		
3	An.49	Prishje struktura betoni te pusetave ekzistuese te shiut	m3	0,6		
4	2.37/2a	Transport mbeturina ndertimi deri 2km	m3	20		
5	2,1	Germim dheu themel me krahe+transp.	m3	10		
6	2.110/2	Ndertim mure butobetoni (themel+xokol) Detaj "A"	m3	4		
7	2.262/3	Shtrese betoni t=10cm C-12/15	m3	1,5		
8	2,258	Shtrese zhavorri t = 15 cm	m3	2,2		
9	2.111/2	Mure betoni C-12/15 (kanali I ujrave te shiut tek porta e hyrjes + mbingritje e pusetes hyrjes	m3	3		
10	Man.2 An	F.V porte rreshqitese dekorative	m2	12		
11	2,401	Boje vaji sip.metalike (porta)	m2	12		
12	2,414	Konstruksione metalike zgare ne betonin e pusetes tek porta e hyrjes	ton	0,08		
		SHUMA " 1 "				
		2. RINDERTIM I AVLLISE EKZISTUESE				
1	2,1	Germim dheu themel me krahe+transp.	m3	4		
2	2.110/2	Ndertim mure butobetoni themel+xokol C-12/15 (avllia)	m3	6,8		
3	2,88	Ndertim mure me blloqe betoni t	m3	2,6		

		=20cm			
4	2.121/1	Brez betoni C-16/20 mbi mure me blloqe	m3	0,6	
5	2,331	Suvatim nga jashte I murit me blloqe	m2	15	
6	2,399	Bojatisje me gelqere e murit me blloqe	m2	15	
		SHUMA " 2 "			
		3. PUNIME RIKONSTRUKSIONI NE RRUGE			
1	3.193/a	Shtrese zhavorr lumi t=10cm me cilindrim	m2	460	
2	3.212/a	Shtrese stabilizanti t = 5 cm	m2	460	
3	3.620.	Shtrese rruge + trotuari me pllaka betoni koc me t = 6cm mbi rere me rulum	m2	460	
4	3.617/1	F.V bordura p/pergat. 15 x 30 cm	ml	140	
5	M2 An22	Pusete b/a shiu (40x40) h = 100 cm me zgare hekuri	cope	4	
6	3.An/53	F.V shtylla metalike per ndricim me H=7m , d = 160 mm	cope	5	
7	2.a-129	F.V ndricues projektor me llampe SAP-T, 250 ë	cope	2	
8	An.	F.V kabell ABC 2 x 16 mm2 (2 fije)	ml	150	
9	An.50	Tabele drejtkendore (tregimi) A X B (60 X 90)	cope	1	
		SHUMA " 3 "			
		PUNIME NE BLOKUN E VARREZAVE			
		1. RRUGICA Nr. 1			
1	2,1	Germim dheu ,rrafshime kat.III + transport me karro dore deri 10ml	m3	6	
2	2,288	Trotuar me pllaka granili me boje trotuari pa borduren e betonit	m2	45	
3	3,616	F.V bordura betoni (12 x 25) cm	ml	90	
		SHUMA Nr.1			

		2. RRUGICA Nr. 2			
1	2,1	Germim dheu, rrafshime kat. III + transport me karro dore deri 10 ml	m3	5	
2	2,288	Trotuar me pllaka granili me boje trotuari pa borduren e betonit	m2	140	
3	3,616	F.V bordura betoni (12 x 25) cm	ml	95	
	2.110/2	Themel + xokol butobetoni C-12/15	m3	4,8	
		SHUMA Nr. 2			
		3. RRUGICA Nr. 3			
1	3.87/a	Germim dheu kanal, gjeresi -2m toke zak. Rrafshime ,me shkarkim ne toke	m3	8	
2	3.193/b	Shtrese zhavorr lumi t=20cm me cilindrim	m2	168	
3	3.212/a	Shtrese stabilizanti t = 5 cm	m2	168	
4	3.620.	Shtrese rruge i me pllaka betoni koc me t = 6cm mbi rere me rulim	m2	168	
5	3.617/1	F.V bordura betoni (15 x 30)cm p.perg.	ml	100	
6	2.110/2	Themel + xokol butobetoni C-12/15	m3	7	
		SHUMA Nr.3			
		4. RRUGICA Nr. " 4 "			
1	2,1	Germim dheu , rrafshime kat III + transport me karro dore deri 10 ml	m3	0,5	
2	2,288	F.V pllaka granili me boje trotuari pa borduren e betonit	m2	10	
3	3,616	F.V bordura betoni (12 x 25) cm	ml	11	
		SHUMA Nr. 4			
		5. RRUGICA Nr. " 5 "			
1	2,1	Germim dheu , rrafshime kat III + transport me karro dore deri 10 ml	m3	10	

2	2,288	F.V pllaka granili me boje trotuari pa borduren e betonit	m2	110		
3	3,616	F.V bordura betoni (12x25) p.pergatitura	ml	112		
SHUMA Nr. 5						
6. PUNIME SISTEMIMI + KANALIZIMI I UJRAVE TE SHIUT						
1	3.47/1a	Mbushje , rrafshim,ngjeshje dheu me tokmak elektrik cdo 30 cm	m3	80		
2	3.87/a	Germim dheu kanal toke e bute me eskavator me goma 0.25m3 me shkarkim ne toke	m3	18		
3	2,523	F.V tub pvc d = 200 mm kanalizimi I brinjezuar	ml	50		
4	An.22/1	F.V puse te shiu b/a (40 x 60) me h= 100 cm me kapak zgare hekuri	cope	2		
SHUMA Nr. 6						
7. PUNIME SISTEMIMI SHESHI SIPER SHESHIT KRYESOR EKZISTUES						
1	2,1	Germim dheu themel me krahe kat III	m3	5		
2	3,19	Hedhje, rrafshim , mbushje dheu ,ngjeshje me krahe	m3	2		
3	2.110/2	Ndertim mure butobetoni C-12/15 themel + xokol	m3	6		
4	3.193/b	Shtrese zhavorr lumi me cilindrim t=20cm	m2	50		
5	3.212/b	Shtrese stabilizanti t = 10 cm	m2	50		
6	3.620.	Shtrese rrugice (shesh) me pllaka betoni (koc) mbi rere me t = 6cm	m2	50		
SHUMA Nr. 7						
8. NDERTIM RRUGICA ME TROTUAR ME PLLAKA TROTUARI + BORDURA NE DY BLOQET E VARREZAVE (Gjatesi totale L=100ml)						

1	2,1	Germim dheu , rrafshime kat III + transport me karro dore deri 10 ml	m3	10		
2	2,288	Trotuar me pllaka granili me boje pa borduren e betonit	m2	100		
3	3,616	F.V bordura betoni (12x25) te p.pergatit	ml	200		
		SHUMA Nr. 8				
		SHUMA (1 - - - - 8)				
		Fond rezerve 5 %				
		SHUMA				
		T.V.SH 20 %				

III.2.5.Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kërkimin e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e dy autobetonjereve stacionare 1-2m³, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në preventivin e punimeve të sipërcituar, autoriteti kontraktor ka parashikuar zëra të ndryshme punimesh për kryerjen e të cilave janë tepër të nevojshme këto autobetonjere, duke marrë në konsideratë dhe afatin e përfundimit të punimeve që është 25 ditë nga dita e lidhjes së kontratës, por referuar volumit të punimeve, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e 2 autobetonjereve stacionare 1-2m³, është një kërkesë e ekzagjeruar, në kushtet kur procesi i punës që do të kryhet do të realizohet edhe betonierja 0.5 m³. Për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet rishikoj kriterin e sipërcituar duke ripërllogaritur numrin e autobetonjereve stacionare, duke i ulur ato në përputhje dhe proporcion me kontratën objekt prokurimi.

III.2.6.Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kërkimin e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e një aparati për ngjitje tubash, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në preventivin e punimeve të cituar në paragrafin III.2.4 të këtij vendimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar zërin e punimeve “*F.V tub pvc d = 200 mm kanalizimi i brinjezuar në sasishtë 50 ml*”. Sa më sipër, nga verifikimet e kryera mbi karakteristikat dhe specifikimet teknike të pajisjeve të ndërtimit, rezulton se për lidhjen e tubave pvc është tepër i domosdoshëm aparati për ngjitjen e tubave. Për këtë arsye, KPP gjykon se kërkimi i autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e një aparati për ngjitje tubash është në përputhje me punimet e parashikuara për tu kryer në preventivin e punimeve dhe për rrjedhojë kjo kërkesë është në përpjestim me volumin e punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe jodiskriminues, për këtë arsye në këtë pikë ky kriter nuk duhet ndryshuar.

III.2.7.Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kërkimin e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e një ruli vibrues mbi 10 ton, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në preventivin e punimeve të cituar në paragrafin III.2.4 të këtij vendimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar punime për të cilat është tepër i nevojshëm disponimi i një ruli vibrues, por përcaktimi i dyshemesë në tonazhin e kësaj makinerie mbi 10 ton, ndërkohë që egzistojnë

rula vibrues me tonazh më të ulët që arrijnë të njëjtin rezultat, është një kufizim i panevojshëm dhe diskriminues, kjo referuar edhe volumit jo shumë të lartë të këtij zëri punimesh. Për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet rishikoj kriterin e sipërcituar duke mos e kufizuar tonazhin e rullit vibrues të kërkuar.

III.2.8.Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kërkimin e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e 6 tabelave paralajmëruese, 6 kompleteve të ndihmës së shpejtë dhe 3 fikseve të zjarrit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në preventivin e punimeve të sipërcituar, autoriteti kontraktor ka parashikuar zëra të ndryshme punimesh për kryerjen e të cilave janë tepër të nevojshme aksesorët e sipërcituar, pasi referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për sigurinë e shëndetit në punë, sigurisë në kantier dhe mbrojtjen kundër zjarrit, është e detyrueshme të merren masa parandaluese në kantier gjatë procesit të punës, për të shmangur aksidentet apo zjarret e mundshme, si dhe për të minimizuar pasojat e tyre. Por referuar volumit të punimeve si dhe objektit të kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin e 6 tabelave paralajmëruese, 6 kompleteve të ndihmës së shpejtë dhe 3 fikseve të zjarrit, është një kërkesë e ekzagjeruar, në kushtet kur procesi i punës që do të kryhet nuk është në volume të tilla për të kërkuar këtë sasi aksesorësh. Për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet rishikoj kriterin e sipërcituar duke ripërllogaritur numrin e tyre, duke i ulur ato në përputhje dhe proporcion me kontratën objekt prokurimi.

III.2.9.Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kërkimin e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e 14 kokore pune, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi, shtojca 10 pika 2.3.5, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar *“1 Drejtues Teknik inxhinier ndërtimi; 1 Drejtues Teknik inxhinier topograf/gjeodet; 1 Drejtues Teknik inxhinier mekanik; 1 Inxhinier hidroteknik; 1 Shofer; 2 Murator; 1 Teknik Ndërtimi; 1 Saldator, 2 Manovrator; 1 Hekurlidhes”*. Sa më sipër rezulton se nga autoriteti kontraktor, për të kryer proceset e nevojshme të punës në zbatim të kontratës objekt prokurimi, janë kërkuar 12 punonjës. Për këtë arsye, KPP gjykon se kërkimi i autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e 14 kokore pune nuk është në përputhje me fuqinë punëtore të kërkuar, e për rrjedhojë kjo kërkesë është e ekzagjeruar. Për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet rishikoj kriterin e sipërcituar duke ripërllogaritur numrin e tyre, duke i ulur ato në përputhje me fuqinë punëtore të kërkuar prej saj, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.2.10.Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kërkimin e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e saldatrices me argon 400A, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në preventivin e punimeve të cituar në paragrafin III.2.4 të këtij vendimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar punime për të cilat është tepër i nevojshëm disponimi i një saldatriceje, por përcaktimi i llojit të saldatrices (me argon 400A), ndërkohë që egzistojnë disa lloje saldatricesh që arrijnë të njëjtin rezultat, është një përcaktim i panevojshëm dhe diskriminues, kjo referuar edhe volumit jo shumë të lartë të këtij zëri punimesh. Vlen të theksohet se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e

gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (saldatricen), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet rishikoj kriterin e sipërcituar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kriterin e mësipërm pjesërisht qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“[...]Vertetimi per Numri mesatar i punonjësve për periudhën Janar 2015 -Shtator 2017 të jetë jo më pak se 14 punonjës eshte shume i ekzegjuar per hapsiren kohore shume te madhe te shtrirjes me shume se 3 vjet dhe diskriminon OE prandaj edhe kjo pike duhet te Modifikohet deri ne 10 Punonjes ose te shikohet ecuria e nje viti me pare me qellim qe te siguroje barazi dhe konkurrence te drejte e te ndershme e jo diskriminuese te OE pjesemares ne procedurat e prokurimit Publik.[...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1.Në dokumentat e tenderit, shtojca 10 pika 2.3.4, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar: *“Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve për periudhën Janar 2015 –Shtator 2017 të jetë jo më pak se 14 punonjës. Për të vërtetuar këtë ofertuesi duhet të paraqesë -Listëpagesat për periudhën Janar 2015 - Shtator 2017. -Vërtetim për numrin mesatar të punonjësve lëshuar nga organet tatimore për periudhën Janar 2015 – Shtator 2017”*

III.3.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “a” dhe “b” ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”*

III.3.3. Lidhur me kundërshtimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi dëshminë për numrin mesatar të së fuqisë punëtore të kërkuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë një punësim mesatar i të paktën 14 punonjësve, për periudhën Janar 2015 – Shtator 2017. Ndërkohë që në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi, shtojca 10 pika 2.3.5, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar “1 Drejtues Teknik inxhinier ndërtimi; 1 Drejtues Teknik inxhinier topograf/gjeodet; 1 Drejtues Teknik inxhinier mekanik; 1 Inxhinier hidroteknik; 1 Shofer; 2 Murator; 1 Teknik Ndërtimi; 1 Saldator, 2 Manovrator; 1 Hekurlidhes”. Sa më sipër rezulton se nga autoriteti kontraktor, për të kryer proceset e nevojshme të punës në zbatim të kontratës objekt prokurimi, janë kërkuar 12 punonjës. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë duke përfshirë në të vetëm ata operatorë të cilët plotësojnë numrin e kërkuar prej 14 punonjësish duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë një shërbim me cilësi të objektit si dhe mund të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese për këtë procedurë prokurimi do të penalizohen vetëm për faktin se nuk përmbushin numrin e kërkuar të punonjësve e cila në rastin konkret nuk është i argumentuar dhe justifikuar nga autoriteti kontraktor. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar kushte kufizuese sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjërë të operatorëve ekonomikë. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Në këtë kuptim referuar bazës ligjore sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin e kriterit sa më sipër duke vendosur një numër të arsyeshëm punonjësish dhe proporcional me objektin e prokurimit në respekt të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, në lidhje me periudhën që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke kërkuar një kohë më të shkurtër në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: ” d) *Operatori ekonomik duhet të ketë të siguar në listepagesa për periudhën Janar 2016 -Shtator 2017. Duhet të modifikohet Janar- shtator: 2017. 2. Shofer (nje) (per shoferin të paraqitet deshmia e kualifikimit profesional të leshuar nga insitucionet perkatase) Duhet të modifikohet per shoferin të paraqitet deshmia e kualifikimit Leje Drejtimi (Patente).*

3. Murator (dy) (per muratoret te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional dhe deshmia e kualifikimit te sigurimit teknik , te leshuar nga institucionet perkatese) Duhet te modifikohet te hiqet fare

4. Teknik Ndertimi (nje) (per teknikun e ndertimit te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional) Duhet te modifikohet te hiqet Fare sepse e mbulon drejtuesi teknik te eshte ing. E eshte drejtuesi me i larte i shoqerise

e) Operatori ekonomik duhet te kete kontrate pune me keto specialiste :

1. Saldator (nje) te paraqitet (deshmi kualifikimi profesional , kontrata e punes dhe deshmia e sigurimit teknik) Duhet te modifikohet te hiqet fare

2. Manovrator (dy) te paraqitet (deshmi kualifikimi profesional , kontrata e punes dhe deshmia e sigurimit teknik) Duhet te modifikohet te hiqet fare

3. Hekurlidhes (nje) te paraqitet (deshmia e kualifikimit profesional dhe kontrata e punes) Duhet te modifikohet te hiqet fare.

Pikat e larte permendur duhet te modifikohen sipas kerkeses sone”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1.Në dokumentat e tenderit, shtojca 10 pika 2.3.5 gërma d dhe e, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është kërkuar: “d)Operatori ekonomik duhet te kete te siguruar ne listepagesa per periudhen Janar 2016 – Shtator 2017 :

1. Inxhinier hidroteknik (nje) (per inxhinierin te paraqitet diploma dhe CV); 2. Shofer (nje) (per shoferin te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional te leshuar nga insitucionet perkatese); 3. Murator (dy) (per muratoret te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional dhe deshmia e kualifikimit te sigurimit teknik , te leshuar nga institucionet perkatese); 4. Teknik Ndertimi (nje) (per teknikun e ndertimit te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional)

e) Operatori ekonomik duhet te kete kontrate pune me keto specialiste :

1. Saldator (nje) te paraqitet (deshmi kualifikimi profesional, kontrata e punes dhe deshmia e sigurimit teknik); 2. Manovrator (dy) te paraqitet (deshmi kualifikimi profesional, kontrata e punes dhe deshmia e sigurimit teknik); 3. Hekurlidhes (nje) te paraqitet (deshmia e kualifikimit profesional dhe kontrata e punes)”

III.4.2. Në nenin 26, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.4.3.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të

cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (fuqinë punëtore), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.4.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kërkimin e autoritetit kontraktor për periudhën që duhet të figurojnë të siguruar në listëpagesa fuqinë punëtore, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se krahas detyrimit të paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesmarrës të mundshëm të dëshmime për punonjës të kualifikuar, autoriteti kontraktor ka kërkuar edhe detyrimin e punonjësve të përfshirë në listëpagesa për periudhën Janar 2016-Shtator 2017. Në lidhje me këtë pikë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në respekt të testit në lidhje me proporcionalitetin kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor është më shumë sesa nevojitet për të realizuar synimin e kërkesës. Në këtë kontekst, sikurse ka interpretuar në paragrafin III.3.3 të këtij vendimi, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke kërkuar një kohë më të shkurtër në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.

Ndërsa lidhur me specialistët e kërkuar ”1 Shofer; 2 Murator; 1 Teknik Ndertimi; 1 Saldator, 2 Manovrator; 1 Hekurlidhes”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se në preventivin e punimeve të cituar në paragrafin III.2.4 të këtij vendimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar punime për të cilat është tepër i nevojshëm stafi i kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe kërkimi i tyre nuk përbën tejkallim të proporcionalitetit të volumit dhe objektit të kontratës, qoftë në specialitetin, qoftë në numrin e kërkuar.

Gjithashtu, dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor për specialistët e sipërcituar, për të vërtetuar kualifikimin e tyre dhe kontratën e punës është në proporcion dhe në përputhje me objektin e kontratës, me përjashtim të specialistit “Shofer”, për të cilin autoriteti kontraktor nuk ka specifikuar në mënyrë të qartë dokumentacionin për të provuar kualifikimin e tij profesional. KPP gjykon se autoritetet kontraktore, në dokumentat standarte të tenderit duhet të vendosin kriteret të kuptueshme për operatorët ekonomik të interesuar, në proporcion me volumet e kontratës që prokurohet, jo diskriminuese, si dhe duhet të përcaktojnë dokumentacionin konkret me anë të të cilit duhet të përmbushet kriteri i sipërcituar në kuptim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2 ku përcaktohet se: *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të bëjë rishikimin dhe qartësimin e kriterit të sipërcituar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kriterin e mësipërm pjesërisht qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “SHEHU” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me objekt: “*Rikonstruksioni i varrezave publike Peshkopi, Viti 2017*”, me nr. REF-31521-10-26-2017, me fond limit 3,725,685 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 17.11.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “SHEHU” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1664 Protokoli, Datë 08.11.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha